

QEVERISJE E MIRË ⇒ qeverisje me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje, transparencë, kërkesë dhe përgjigje, akses, informim, pjesëmarrje qytetare.



PJESËMARRJA QYTETARE nënkupton përfshirjen e qytetareve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit të mirëqenies së qytetareve.

Bëhu aktiv!

Merr pjesë në vendimmarrje!

Të drejtat e grave – të drejta njerëzore

Pjesëmarrje në vendimmarrje – e drejtë themelore

Mbro të drejtën tënde!

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PJESËMARRJA E GRAVE NË KËTË PROCES?

- Është e rëndësishme pasi shumë prej prioritetëve lidhen me shërbimet që gratë kanë nevojë .
- Zëri i grave në takime dhe dëgjesa publike për nevojat në komunitet, bën që bashkia të dëgjojë edhe nevojat e tyre dhe të përshtatë prioritetet në buxhetin e saj.

BASHKËPUNËTORËT:

- Bashkia Dibër & Njësitë Administrative
- OJQ-të lokale
- Kryetarët e fshatrave
- Punonjës të arsimit dhe shëndetit
- Individë aktivë në komunitet

NA NDIQNI:

-  Agritra-Vizion
-  www.agritra-vizion.com
-  info@agritra-vizion.com
-  Bulevardi “Elez Isufi”,
Qendra e Biznesit, Kati 3, Ap 5
Peshkopi, Dibër.
Tel/fax: +355 218 2 2796




PËRMIRËSIMI I QEVERISJES VENDORE NËPËRMJET NGRITJES DHE AKTIVIZIMIT TË GRUPEVE KOMUNITARE ME BAZË GJINORE DHE RITJES SË NUMRIT TË GRAVE NË VENDIMMARRJE



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky botim u realizua nga qendra Agritra-Vizion, në kuadër të projekti “Përmirësimi i qeverisjes vendor nëpërmjet ngritjes dhe aktivizimit të grupeve komunitare me bazë gjinore dhe rritjes së numrit të grave në vendimmarrje”, me mbështetjen financiare të LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të u përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

QENDRA "AGRITRA-VIZION" ME ZBATIMIN E KËSAJ NISME SYNON:

- Një komunitet më të informuar për të drejtat dhe detyrat e tij dhe të organeve vendimmarrëse, sipas ligjit për të drejtën e informimit dhe respektimin e ligjit për barazinë gjinore.
- Të ndikojë në ndryshimin e mentalitetit në komunitet lidhur me përfshirjen e grave në organet vendimmarrëse në nivel fshati.
- Të ngrejë modele të grupeve komunitare më aktive dhe të orientuar për një qeverisje me pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirëse .

PSE KY PROJEKT?

Bashkia Dibër ka një shtrirje territoriale të konsiderueshme, gjë e cila vështirëson marrjen e informacionit dhe shërbimeve të komunitetit nga bashkia.

- Organet vendimmarrëse me bazë fshati me një përbërje 100% burra.
- Zonë rurale, ku 60% e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike kjo vështirëson akoma më shumë situatën e grave për gjithëpërfshirje sidomos gratë kryefamiljare dhe me probleme sociale.

SHTRIRJA E PROJEKTIT:

Bashkia Dibër, kryesisht Njësitë administrative: Maqellarë, Tomin, Melan, Kastriot, Fushë-Çidhën, Arras, Kala e Dodës, Muhurr, Sllovë, Luzni.

Nisma realizohet përmes aktiviteteve të ndryshme me fokus informimin e aktorëve lokale dhe angazhimin qytetar për një qeverisje më të mirë .

AKTIVITETET

- Takim për prezantim të projektit në Bashkinë Dibër & 10 njësi administrative.
- Takime informuese/ndërgjegjësuese me përfaqësues nga komuniteti në fshatrat e 10 njërive administrative.
- Ngritja e modeleve të grupeve komunitare me balancë gjinore në çdo njësi administrative.
- Trajnimi i grupeve komunitare mbi të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe gjithëpërfshirje.
- Aktiviteti përmbyllës, workshoop për prezantim të rezultateve të projektit.

E DREJTA E INFORMIMIT

- ❖ KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Neni 23, "E drejta e informimit është e garantuar"
- ❖ LIGJI NR. 119/2014 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT"
- ✓ Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

SI TË MARRIM INFORMACION?

Kërkesa për informacion bëhet:

- Me shkrim
- Me postë elektronike
- Sigurimi i informacionit on-line, përmes web-faqeve dhe formave tjera elektronike si; vendimeve, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera me rëndësi, është një mënyrë alternative e marrjes së informacionit dhe përfshirjes në vendimmarrje.

Një qytetar i informuar është një qytetar i lirë

Mekanizmat ligjore për përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen e nivelit lokal, janë;

- **dëgjesat publike**
- **komitetet këshillëdhënëse**
- **grupe studimore,**
- **komisione qytetare**

Mekanizëm tjetër për përfshirjen e qytetarëve në qeverinë lokale është përmes **grupeve komunitare**, të ngritura nga qytetar aktiv, të cilat në dallim nga komitetet këshillëdhënëse nuk kanë ndonjë lidhje me qeverinë lokale.

AKTORËT NË QEVERISJE

Institucionet lokale, partitë politike, grupe qytetare, organizata të shoqërisë civile, media, biznesi, institutet kërkimore, sindikatat, udhëheqës fetar.